

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 2 <sup>TË</sup>					
GRANT-MARRËSIT ORGANIZATA JO FITIM-PRURËSE					
Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
1	Instituti Shqiptar i Shkencave	Monitoro Klientë të Bashkive në Kontrata Publike	Përzgjedhja e kontraktorëve ekonomik, cilësia-integriteti janë të rëndësishme për mirëqeverisje dhe qëllimi i këtij projekti ka të bëjë me monitorimin qytetar të Kontraktorëve Privatë të Bashkive. Synohet a) të krijohen instrumente që lehtësojnë gjetjen, përdorimin dhe ripërdorimin e informacionit mbi kontraktorët, më konkretisht një data bazë me pasaporta me të dhëna për 3500 subjekte Kontraktore me Bashki në dy vitet e para të mandatit 2015-2019; b) rritja e kapacitetit të gazetarëve lokal dhe aktorëve të shoqërisë civile në realizimin e shkrimeve mbi Klientët e Bashkive; c) identifikimi i shpërndarjes së kontratave publike (parasë publike) në klient sipas grupit gjinor.	9	Kombëtar
2	Oxfam Italia	Mobilizimi i komuniteteve: Uji për përmirësimin e jetës rurale	Problemi që synon të adresojë ky projekt, ka të bëjë me mungesën e së drejtës ndaj aksesit për ujë për banorët e Njësisë Administrative Shkrel në bashkinë Shkodër. Synohet përfshirja e komunitetit të zonës Shkrel, fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve nëpërmjet mobilizimit të 1000 banorëve (burra dhe gra) duke realizuar një fushatë të gjerë advokimi për përmirësimin e furnizimit me ujë të 5 fshatrave në këtë zonë.	10	Malësi e Madhe
3	Shoqata "Together for Life"	Lëviz për Kopshin tim	Shërbimi i kopshteve të fëmijëve në qytetin e Tiranës përballat me problematika të shumta, si mbipopullimi, shpërndarja e pabarabartë, mosrespektimi i standardeve të infrastrukturës fizike, të sigurisë dhe higjienës. Projekti synon të kryejë një monitorim të infrastrukturës dhe investimeve të 44 kopshteve të Tiranës për një periudhë 12 mujore, me qëllim informimin e qytetarëve dhe medias për të nxitur përgjegjshmërinë dhe transparencën e pushtetit vendor për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në kopshtet e bashkisë Tiranë.	12	Tiranë
4	Qendra për Qeverisjen e Mirë	Monitorim i performancës së Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve( MIM) në bashkinë Kuçovë dhe përgatitja e Metodologjisë së Performancës	Rritja e iniciativës dhe reagimit të qytetarëve të bashkisë Kuçovë për të përmirësuar situatën aktuale të shërbimit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (MIM) nëpërmjet angazhimit të tyre në procesin e monitorimit të këtij shërbimi. Projekti synon: a) të hartojë një dokument monitorimi për MIM në Bashkinë Kuçovë në bashkëpunim me organizata mjedisore, rome dhe grass; b) advokim dhe llogaridhënie për përmirësimin e MIM nëpërmjet evidencave dhe në bashkëpunim me organizatat partnere vendore.	8	Kuçovë
5	Epoka e Re	Bordi Këshillimor Rinor Mallakastër	Nëpërmjet këtij projekti do të krijohet Grupi Këshillimor Rinor në Bashkinë Mallakastër, i cili nëpërmjet aksionit rinor do të nxisë aktivizimin qytetar dhe ndërmarrjen e nismave advokuese dhe lobuese konkrete për zgjidhjen e problemeve të komunitetit nga pushteti vendor. Projekti synon: a) nxitjen e transparencës dhe ndërgjegjësimit qytetar nëpërmjet fushatave informuese dhe lobuese për të ushtruar trysni ndaj bashkisë në përbushjen e premtimeve përkundrejt qytetarëve; b) fuqizimin e Komisionit Këshillimor Rinor për të mobilizuar të rinjtë në influencimin e politikave lokale dhe qendrore me të mira për të rinjtë dhe komunitetin.	10	Mallakastër
6	Qendra Burimore e Alternativave të Zhvillimit	Merr pjesë monitoro vepra për shërbime cilësore	Promovimi i transparencës dhe përgjegjshmërisë së bashkisë Rrogozhinë përmes inkurajimit të pjesëmarrjes qytetare në procesin e monitorimit të performancës së shërbimit të furnizimit me ujë. Konkretisht projektin synon a) rritjen e përfshirjes qytetare në monitorimin e shërbimit të ujit duke përdorur metodologjinë e " kartës së zërit të komunitetit ( KZK); b) krijimin dhe rritjen e kapaciteteve për tre grupet monitoruese komunitare për ujë nga 6 pjesëtarë secili, duke i pajisur me teknika dhe metoda për advokimin dhe ngritjen e zërit për të drejtat në lidhje me ujë; c) sensibilizimin dhe angazhimin e 60% të komunitetit në aktivitete lobuese advokuese në lidhje me të drejtat dhe detyrimet për shërbimin e ujit.	8	Rrogozhinë
7	Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje	Buxheti i Qytetarit, Transparencë në rritje dhe pjesëmarrje Aktive në Bashkinë Lezhë	Nxjtja e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve, medias, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në hartimin, monitorimin dhe implementimin e Buxhetit në Bashkinë e Lezhës është qëllimi kryesor i kësaj ndërhyrjeje. Projekti synon a) realizimin e "Buxhetit të Qytetarit", që ka të bëjë me prezantimin, njohjen dhe trajnimin e qytetarëve të Lezhës me konceptin e buxhetit vendor dhe mënyrat sesi politike bëra buxhetore ndikon në jetën dhe aktivitetin e komunitetit; b) monitorimin dhe përfshirjen aktive të zërit qytetar në politike bëren buxhetore, angazhimin e të rinjve dhe medias për t'u bërë pjesë e proceseve politike bërëse e vendimmarrëse; c) trajtimin e Buxhetit të Qytetarëve duke marrë në konsideratë edhe barazinë gjinore si një nga pikat me interes për komunitetin.	12	Lezhë

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 2 <sup>TË</sup>					
GRANT-MARRËSIT ORGANIZATA JO FITIM-PRURËSE					
Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
8	Levizja Rinore Egjiptiane Rome	Aktivizëm qytetar për llobim dhe advokaci për problemin e strehimit në Bashkinë Elbasan	Përmirësimi i jetës së familjeve të pastreha Rome dhe Egjiptiane në bashkinë e Elbasanit duke rritur vëmendjen e pushtetit lokal kundrejt kësaj problematike dhe vënë në zbatim programin e Bonusit të Strehimit përbën qëllimin kryesor të këtij projekti. Synohet që: a) të advokohet për vendosjen e një zëri të veçantë për Bonusin e Strehimit në buxhetin e bashkisë Elbasan për familjet Rome dhe Egjiptiane të Njësisë Administrative Papër dhe Bradashesh; b) prodhohen dhe publikohen materiale mediatike për informimin e familjeve si dhe paraqitjen e problematikave gjatë procesit.	7	Elbasan
9	Art Kontakt	Vide(m)okraci	Angazhimi i të rinjve të Qarkut Tiranë të marrin një rol dhe përgjegjësi në çështje të demokracisë vendore me interesi publik, duke përdorur artin (videon) dhe mediat sociale si mjete të komunikimit masiv përbën qëllimin kryesor të kësaj ndërhyrjeje. Projekti synon: a) realizimin dhe shpërndarjen masive në mediat sociale të një portofoli prej 100-150 videosh që do të realizohen nga të rinjtë që do të angazhohen, në mënyre që mesazhet që përcjellin të ndërgjegjësojnë pushtetin vendor dhe qytetarët në lidhje me çështje të demokracisë vendore.	8	Tiranë (Zona urbane, Bashkia Kamëz , Bashkia Kavajë)
10	Infini+	Nxënësit Lëvizin Tiranën	Ushtrimi i presionit pozitiv ndaj Bashkisë Tiranë për të shtuar vëmendjen ndaj 13 njësisve administrative rurale përbën qëllimin kryesor të këtij projekti. Synohet që përmes angazhimit të të rinjve në këtë proces të identifikohen ide për përmirësimin e zonave dhe përfshirjen e tyre në aktivitetet advokuese duke përdorur dokumentarin si mjet për të pasqyruar problematikat dhe për të llobuar për ndryshimin e situatës në Njësitë përkatëse Administrative.	12	Tirane (Zall- Bastar, Zall Herr, Shëngjergj, Dajt, Kashar, Farkë, Ndroq, Vaqar, Petrelë, Bërhëtitë, Krrabë, Pezë dhe Baldushk)
11	Qendra për Çështje të Informimit Publik	Monitorimi i performancës së Këshillit Bashkiak dhe procesit të vendim-marrjes, Tiranë, Kamëz, Vorë	Promovimi i pjesëmarrjes në vendim-marrje të rinjve nga zonat rurale dhe rritja e zbatueshmërisë së ligjit të ri 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", përbën qëllimin kryesor të këtij projekti. Synohet që a) të monitorohen këshillat bashkiakë në Tiranë Kamëz dhe Vorë (rreth Tiranë) për zbatimin e kapitullit IV dhe IX të ligjit të ri organik "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe të përllogaritet niveli i zbatimit të tij për secilin prej tyre; b) të ushtrohet presion i vazhdueshëm brenda hapësirave që lejon ligji ndaj këshillave bashkiake përmes ekspozimit të vendim-marrjes së tyre dhe përmes vlerësimeve sistematike për zbatimin rigoroz të kërkesave të ligjeve në fuqi për një vendim-marrje të hapur dhe demokratike; c) të ndërtohet dhe konsolidohet një matricë monitoruese, e cila të mund të përdoret në vijueshmëri nga aktorë të interesuar të shoqërisë civile për matjen dhe vlerësimin e proceseve vendim-marrëse në nivel vendor.	12	Tiranë, Kamëz, Vorë
12	Shoqata për Zhvillim Informim dhe Barazi Gjinore	Iniciativa rinore për zhvillim social lokal "Të rinjte flasin"	Ngritja, funksionimi dhe institucionalizimi "Këshillit Rinor" për organizimin dhe përfshirjen e të rinjve në procesin e llogaridhënies në nivel vendor, si një lëvizje thelbësore kritike për ndryshim social, përbën qëllimin kryesor të këtij projekti. Synohet që a) të ngrihet një mekanizëm llogaridhënieje përmes një platforme efektive që siguron pjesëmarrje të të rinjve në çështjet/aktivitetet e këshillit bashkiak, monitorimin e vendimeve që prekin direkt ata dhe reagimin ndaj këtyre vendimeve nëpërmjet medias dhe aktiviteteve të tjera; b) të ndikojë pushtetin vendor për zhvillimin social dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj të rinjve.	12	Shkodër
13	Qendra "Konsumatori shqiptar"	Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të transportit rreth-qytetas në Bashkinë e Durrësit	Rritja e përgjegjshmërisë së administratës së bashkisë Durrës për të siguruar një shërbim transporti rreth qytetas cilësor dhe të aksesueshëm për konsumatorët- përdorues të këtij shërbimi në këtë bashki përbën qëllimin kryesor të këtij projekti. Synohet që a) 15 të rinj të rrisin kapacitetet e tyre dhe do të angazhohen në monitorimin e shërbimit të transportit publik rreth qytetas në tre linja kryesore transporti, përgjatë periudhës kohore të zbatimit të kësaj iniciative; b) të advokohet pranë Bashkisë Durrës nëpërmjet përgatitjes së dy raporteve të pavarura të monitorimit të linjave të transportit rreth qytetas nga të rinjtë, për të ushtruar presion ndaj strukturave të pushtetit lokal për sigurimin e shërbimeve cilësore të transportit rreth qytetas në tre linjat e targetuara nga ky projekt.	9	Durrës

**PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 2<sup>TË</sup>**

**GRANT-MARRËSIT INDIVIDË**

Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
14	Engjellush Serjani	Këshillatë bashkiakë: Kush janë? Ç'kone? Ç'mak thone?	Monitorimi i vazhdueshëm për të analizuar situatën aktuale, transparencën dhe hartimin e propozimeve për përmirësimin e situatës të përbërjes së këshillatëve lokalë, pjesëmarrje të publikut në vendimarrje, përfaqësimin në të mirë të komuniteteve periferike dhe për të kërkuar më shumë transparencë e përgjegjësi përbën qëllimin kryesor të projektit. Synohet që: a) nëpërmjet monitorimit të mbledhjeve, anketimit të qytetarëve me studentë vullnetarë, bashkëpunimit me mediat lokale e sociale të identifikohet përberja, roli dhe aktivizimi i këshillatëve bashkiakë, niveli i përfaqësimit dhe kontributi i tyre në përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, mbulimin e zonave periferike nga anëtarët e këshillave, lidhjet nepotike, niveli i ansimor, gjimor dhe përkatësia partiake, pjesëmarrja në mbledhje dhe diskutime e këshillatëve, pjesëmarrja qytetarëve gjatë zhvillimit të mbledhjeve, në procesin e vendimarrjes dhe të bashkimit duke rritur deri në 30 % efikasitetin e këshillave bashkiakë; b) të skicohen 67 profile të këshillatëve me të dhëna të monitorimit për atë çka flitet, debatohet dhe vendoset në këshillat bashkiakë; c) të pasqyrohen pas çdo mbledhje të dhënat e monitorimit për pjesëmarrjen dhe aktivizimin e anëtarëve në mbledhjet e këshillave bashkiakë për të rritur interesin e komuniteteve periferike për të vlerësuar punën e të zgjedhurve dhe për të rritur logaridhënien.	9	Gjirokastrë, Dropull, Këlcyrë
15	Rudina Mahilaj	Monitorimi i Aplikacionit Tirana ime	Përmirësimi i aplikacionit (app) "Tirana ime" për t'i shërbyer më mirë qytetarëve të Tiranës është qëllimi kryesor i këtij projekti. Synohet që duke regjistruar sa më shumë probleme dhe duke monitoruar zgjidhjen e tyre mund të realizohet një pasqyrim i funksionalitetit të aplikacionit të sipërpërmendur, si dhe një mundësi për ta përmirësuar atë. Synohet që për një periudhë kohore prej 6 muajsh të regjistrohen problematika të 9 kategorive të të ndryshme dhe të analizohet informacionit për secilën prej tyre.	6	Tiranë
16	Rio Kerpaci	Portofoli qytetar	Monitorimi i Njësi Administrative 1, 9, 10 për zbatimin e ligjit mbi Administrimin e Bashkëpunuesisë në ndërtesat e banimit përbën qëllimin kryesor i këtij projekti. Synohet që a) të krijohet një model pilot monitorimi për zbatueshmërinë e kuadrit institucional dhe ligjor bazuar në ligj; b) të evidentohen modellet e mira të mirë administrimit në komunitet; c) të publikohen, lançohen raste të ndryshme në funksion të miradmirimit përmes medias sociale.	8	Tiranë
17	Merita Brati -Këshilli Rinor Rajonal i Kukësit	Angazhimi Rinor në Komunitet	Angazhimi i të rinjve të Kukësit si katalizatorë ndryshimi për përmirësimin e situatës së tyre në komunitet nëpërmjet monitorimit, lobimit dhe sugjerimit të projekteve konkrete për rininë përbën qëllimin e këtij projekti. Synohet që a) të advokohet për përmirësimin e politikave rinore dhe problematikave të tyre në komunitet nëpërmjet fuqizimit të më shumë se 300 të rinjve; b) të rritet kërkesa për qeverisje të mirë dhe përgjegjshmëri të autoriteteve politik-bërëse dhe rritja e kapaciteteve të Këshillit Rinor në rolin e advokuesit dhe monitoruesit të 8 mbledhjeve të Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e 20 përfaqësuesve të Këshillit Rinor.	10	Kukës
18	Gentiana Ramadani	Forca e Njerëzve'	Pasqyrimi i situatës reale dhe informimi i qytetarëve pas reformës territoriale me qëllim ndërgjegjësimin e palëve, krijimin e hapësirave për debat, përmirësimin e transparencës dhe strukturave sociale të shërbimeve përbën qëllimin kryesor të projektit. Synohet që a) të përdoret media për "nevoja" e qytetarit; b) të zhvillohet një "kulturë besimi" mes qytetarëve dhe administratorëve të qeverisjes lokale duke transmetuar gjenjendjen shqetësimit reale të tyre; c) të sillen qytetarit dhe qeverisja lokale në një pikë takimi, aty ku opinionet e tyre përveç shqetësimeve për shërbimet publike, të gjejnë zgjidhje dhe bashkëpunim për përmirësimin e tyre, në formë debati ose dialogu përballë mikrofonit.	5	Tiranë
19	Bledar Gilaj	Platforma multimediale: Lezha e qytetarëve	Rritja e logaridhënies së zyrtarëve vendorë nëpërmjet monitorimit dhe denoncimit të shkeljeve të të zgjedhurve dhe emëruarve, duke i vënë përballë presioni qytetar është qëllimi kryesor i këtij projekti. Synohet që a) të rritet një faqe e medias sociale si një mjet advokimi për një qeverisje më të mirë në bashkinë Lezhë nëpërmjet publikimit të 20 temave të ndryshme (informuese për problematikën apo investiguese)	8	Lezhë